

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6493
E hënë, 20 dhjetor 2021
çmimi 0.40

Kurti thotë se LV-ja do të jetë opozitë kryesore nëpër komunat që nuk i qeveris

FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

INSTITUCIONET KANË VLERËSUAR SE GJENDJA EPIDEMIOLOGJIKE NË VEND ËSHTË STABILE

FAQE 4-5

KËRKOHET RESPEKTIM I PËRPIKTË I MASAVE KUNDËR COVIDIT



Në kohën kur Evropa po shtrëngon masat kundër Covidit për shkak të variantit Omicron, institucionet shëndetësore në Kosovë u kanë bërë thirrje qytetarëve për kujdes. Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik kanë bërë me dije se gjendja epidemiologjike në vend është stabile, mirëpo kanë theksuar se varianti i ri mund ta përkeqësojë situatën. Sipas këtyre institucioneve, për të shmangur një valë të re infektimesh, qytetarët duhet t'i respektojnë në mënyrë të përpiktë masat kundër Covidit dhe të vaksinohen

AKTUALE



TAHIRI: PROTESTA SOT NË TIRANË ËSHTË EDHE NË MBROJTJE TË KOSOVËS, TË PËRKRAHET NGA TË GJITHË SHOQIPTARËT F. 6

TESTOHEN 180 KANDIDATË PËR PROKURORË TË SHTETIT NË KOSOVË F. 6

HOLANDA FUTET NË IZOLIM PËR SHKAK TË OMICRONIT F. 2

EKONOMI



SA DINI PËR TARIFAT SHITESË TË TRUSTIT? F. 7

KUVENDI MIRATON NË LEXIM TË DYTË BUXHETIN PËR VITIN 2022 F. 7

SPORT



DRITON KUKA DHE DISTRIA KRASNIQI, MË TË MIRËT NË BOTË PËR XHUDO F. 09

Senatori amerikan: Rusia po tenton të krijojë pretekst për luftë

FAQE 4-5



PRIVILEGJET E SERBISË PËR VERIUN E KOSOVËS

FAQE 2

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Senatori amerikan: Rusia po tenton të krijojë pretekst për luftë

WASHINGTON, 19 DHJETOR - Kryetari i Komitetit të Senatit amerikan për Marrëdhënie me Jashtë tha se propozimet e sigurisë që ka prezantuar Moskua, që kanë për qëllim ta shtensionojnë situatën pas grumbullimit të trupave ruse pranë kufirit ukrainas, janë sinjal i qartë se Rusia po "tenton të krijojë pretekst për luftë".

Senatori amerikan Jim Risch (republikan nga Idaho) tha se propozimet e Ruisë nuk janë marrëveshje për siguri, por listë e koncesioneve që Shtetet e Bashkuara dhe NATO duhet të bëjnë për ta kënaqur presidentin rus Vladimir Putin.

Propozimet që u prezantuan më 17 dhjetor nga Ministria e Jashtme ruse kërkojnë që Aleanca Veri-Atlantike (NATO) ta ndalojë zgjerimin nga lindja dhe Moskua kërkon kufizime mbi aktivitetin ushtarak të Aleancës në Evropën Lindore,

përfshirë edhe kufizime në bashkëpunimin me Ukrainën dhe Gjeorgjinë.

"Federata Ruse i bëri këto kërkesa duke e ditur mirë se ato janë plotësisht të papranueshme. Putini e di që Shtetet e Bashkuara dhe 29 aleatët tanë në NATO nuk do të negociojnë të ardhmen e kombeve sovraane si Ukraina, e cila duhet të jetë në gjendje të bëjë zgjedhjet e saj", tha Risch. Senatori Risch i bëri thirrje administratës së presidentit amerikan, Joe Biden dhe aleatëve të NATO-s që të refuzojnë këto kërkesa, por tha se Aleanca duhet të jetë e përgatitur që Putini ta përdorë refuzimin e kërkesave si justifikim për përdorim të forcës ushtarake. Ai, po ashtu, i bëri thirrje Kongresit dhe administratës amerikane që të veprojnë përpara se Rusia ta përshkallëzojë edhe më tej situatën.

Aktualisht Rusia ka vendosur

rreth 100 000 trupa pranë kufirit me Ukrainën. ShBA-ja thotë se me këtë veprim Moskua po përgatitet ta pushtojë Ukrainën.

Propozimet ruse, që synojnë disa prej avancimeve të sigurisë që NATO-ja ka bërë në Evropën Lindore dhe në ish-shtetet sovjetike që prej viteve '90, vijnë në kohën kur tensionet ndërmjet Uashingtonit dhe Kremlinit kanë arritur në nivelin që ishin pas Luftës së Ftohtë.

Një zyrtar i administratës amerikane tha më 17 dhjetor se disa nga propozimet ruse ishin "të papranueshme", por tha se propozimet e tjera "meritojnë që të diskutohen". Ky zyrtar tha se ShBA-ja do të konsultohet me aleatët e saj, përfshirë edhe Ukrainën, përpara se t'i përgjigjet Ruisë lidhur me propozimet.

Tensionet ndërmjet Ruisë dhe Kievit janë të larta që prej vitit 2014 kur Rusia aneksoi



Gadishullin ukrainas të Krimesë dhe nisi mbështetjen ushtarake, politike dhe ekonomike për separatistët që po luftojnë në lindje të Ukrainës.

Moska mohon se është e përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në konfliktin në lindje të Ukrainës, pavarësisht se ka shumë prova që e dëshmojnë të kundërtën.

Erdogani zotohet për uljen e inflacionit

ANKARA, 19 DHJETOR - Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, ka thënë se në të kaluarën ka arritur që ta ulë inflacionin për rreth 4 për qind dhe se këtë gjë do të arrijë ta bëjë sërish, teksa çmimet vjetore janë rritur për 21 për qind për shkak të politikave agresive të Erdoganit që kanë çuar në rënien e vlerës së lirës. Erdogan tha se politika e re, e bazuar në nivele të ulëta të interesit, ishte pjesë e "luftës së suksesshme për pavarësi ekonomike", por shumica e ekonomistëve kanë thënë se këto politika janë të gabuara dhe parashikojnë se inflacioni do të shkojë përtej shifrës prej



30-përqindësh gjatë vitit të ardhshëm.

Të premten monedha kombëtare turke, lira, arriti rekordin më të ulët kundrejt

dollarit amerikan. Gjatë këtij viti lira ka humbur rreth 55 për qind të vlerës së saj, përfshirë 37 për qind të vlerës së humbur vetëm gjatë 30 ditëve

të fundit.

Të dielën, më 19 dhjetor, Erdogan përsëriti qëndrimin e tij se normat e interesit shkaktojnë inflacion, duke shtuar se ai nuk të lejojë që turqit të shkatërrohen si pasojë e normave të larta të kredive.

"Herët ose vonë, siç e kemi ulur inflacionin për 4 për qind kur unë erdha në pushtet, do ta ulim sërish", tha Erdogan. "Do Zoti, së shpejti inflacioni do të fillojë të bie", shtoi ai. Më 2011 inflacioni kishte rënë për rreth 4 për qind, përpara se të fillonte të rritej gradualisht nga viti 2017. Në nëntor të këtij viti inflacioni u rrit nga 3.5 në

21.3 për qind.

Më 16 dhjetor Erdogan njoftoi se do ta rrisë pagën minimale për 50 për qind. Kjo lëvizje pritet që ta rrisë inflacionin e përgjithshëm të çmimeve të konsumit me 3.5 deri në 10 pikë të përqindjes.

Shumë qytetarë në Turqi kanë thënë se rritja e pagave nuk do të mjaftojë, pasi çmimet e jetesës janë rritur shumë. Për shkak të presionit nga Erdogan, Banka Qendrore ka ulur normat e interesit që prej muajit shtator. Erdogan ka argumentuar se ky model do t'i rrisë eksportet, do t'i nxisë punësimet, investimet dhe rritjen ekonomike.

Holanda futet në izolim për shkak të Omicronit

AMSTERDAM, 19 DHJETOR - Holanda ka njoftuar se do ta vendosë masën e izolimit gjatë Krishtlindjes për shkak të shqetësimeve lidhur me variantin e ri të koronavirusit, Omicron. Dyqanet jothelbësore, shkollat, baret, restorantet dhe objektet e tjera publike do të jenë të mbyllura deri të paktën në mes të janarit. Kryeministri holandez Mark Rutte tha se masat e reja ishin "të pashmangshme". Këto janë masat më të ashpra që ndonjë

shtet ka marrë deri më tani për shkak të variantit të ri Omicron.

Shtetet në mbarë Evropën kanë ashpërsuar kufizimet, teksa Omicroni, një variant me shumë mutacione, po përhapet në kontinent. Rregullat e reja në Holandë, që do të hyjnë në fuqi të dielën, u morën pas një takimi ndërmjet qeverisë holandeze dhe ekspertëve shëndetësorë. "Holanda edhe një herë po mbyllet", tha Rutte në një konferencë për medie.

Ekspertët thonë se Omicroni pritet të bëhet variant dominues në Holandë gjatë periudhës ndërmjet Krishtlindjes dhe Vitit të Ri.

Për javë të tëra ka pasur masa të kufizimit të lëvizjes dhe mbyllje të objekteve kulturore me qëllim që të frenohet përhapja e variantit të ri. Prej fillimit të pandemisë Instituti Kombëtar për Shëndetësi Publike në Holandë ka raportuar për mbi 2.9 milionë raste me koronavirus dhe mbi 20 000 vdekje.



INSTITUCIONET KANË VLERËSUAR SE GJENDJA EPIDEMIOLOGJIKE NË VEND ËSHTË STABILE

Kërkohet respektim i përpiktë i masave kundër Covidit



Në kohën kur Evropa po shtrëngon masat kundër Covidit për shkak të variantit Omicron, institucionet shëndetësore në Kosovë u kanë bërë thirrje qytetarëve për kujdes. Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik kanë bërë me dije se gjendja epidemiologjike në vend është stabile, mirëpo kanë theksuar se varianti i ri mund ta përkeqësojë situatën. Sipas këtyre institucioneve, për të shmangur një valë të re infektimesh qytetarët duhet t'i respektojnë në mënyrë të përpiktë masat kundër Covidit dhe të vaksinohen

EPOKA
ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik u kanë bërë thirrje qytetarëve të Kosovës që t'i respektojnë masat kundër Covidit gjatë festave të fundvitit. Këto institucione kanë vlerësuar se gjendja epidemiologjike në vend është stabile, por kanë bërë me dije se situata mund të përkeqësohet nga varianti i ri, Omicron, i cili është vlerësuar si shqetësues nga OBSH-ja. "Dhjetori na gjen me situatën epidemiologjike relativisht të qetë, mirëpo nën rrezikun e lartë për një valë të re gjatë javëve në vijim, gjë që na detyron përsëri ta rritim vigjilencën tonë. Si gjithnjë, do t'i mirëpresim mërgimtarët tanë, sepse janë pjesë integrale e shoqërisë sonë, megjithëse edhe kësaj radhe do të na duhet të kufizohemi nga manifestimet masive, sepse paraqesin rrezik të lartë në këtë situatë", ka vlerësuar Ministria e Shëndetësisë përmes

një komunikate për media.

Kjo ministri ka treguar se zbatimi efikas i masave është i domosdoshëm. "Për shkak se këto rreziqe mund të fillojnë të shfaqen brenda ditësh, zbatimi më efikas i masave është jo vetëm i domosdoshëm, por dhe çështje urgjente. Ndërkohë që secili nga ne t'i zbatojmë masat, le ta inkurajojmë njëri-tjetrin për t'u vaksinuar me të dyja dozat, e kur të vijë radha edhe me dozën përforcuese/të tretë. Tashmë është shumë lehtë: pa termin, kudo dhe pavarësisht vendbanimit e shtetësisë. Ministria e Shëndetësisë nuk njuh detyrë më të rëndësishme sesa të mbrojtë jetën dhe shëndetin e qytetarëve tanë, me të gjitha mjetet që i ka në dispozicion", ka bërë me dije MSh-j.

Ndërsa IKShPK-ja ka vlerësuar se situata epidemiologjike mund të përkeqësohet në rast të rritjes së rasteve të reja. "Situata epidemiologjike në Kosovë aktualisht është stabile, por në rajon, Evropë dhe botë është

rënduar javët e fundit me shfaqjen e variantit të ri të virusit SARS CoV-2 Omicron (B.1.1.529) i cili është raportuar tashmë në shumë shtete të botës dhe rrezikon përhapjen e këtij varianti edhe në Republikën e Kosovës duke marrë parasysh festat e fundvitit dhe ardhjen e një numri të madh të qytetarëve nga shtetet me numër të rritur të rasteve. Ne jemi duke vazhduar pandërprerë gjurmimin e të gjitha rasteve, kontakteve të rasteve në komunitet dhe diagnostikimin laboratorik. Situata epidemiologjike mund të përkeqësohet në rast të rritjes së rasteve të reja, andaj IKShPK apelon tek të gjithë qytetarët që të festojmë së bashku duke respektuar masat sipas vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës", është thënë në komunikatën për medie të këtij instituti.

Instituti nga institucionet e rendit ka kërkuar zbatim të përpiktë të masave kundër Covidit. "Për shkak të rrezikshmërisë së lartë të përhapjes së Covid-19, bëjmë thirrje në veçanti për kujdes dhe mosgrumbullim. Ndërsa rekomandojmë institucionet përgjegjëse të mbikëqyrin me përpikëri dhe të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e masave për parandalimin dhe luftimin e pandemisë. Është i domosdoshëm kujdesi i shtuar i të gjithëve që në mënyrë strikte të respektohet distanca fizike, të përdoren maskat, të bëhet dezinfektimi dhe ajrosja e hapësirave, duke pamundësuar dhe shmangur përhapjen eventuale të mëtejme të

infeksionit të Covid-19", ka vlerësuar IKShPK-ja.

Kërkohet marrja e dozës së tretë të vaksinës

Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik u ka bërë thirrje qytetarëve që ta marrin vaksinën kundër Covidit. "Duke qenë se vaksinimi është mënyra më e mirë dhe më e sigurt për ta parandaluar Covid-19, veçanërisht format e rënda të sëmundjes dhe vdekjet, ne vazhdojmë të apelojmë fuqishëm për vaksinim sa më gjithëpërfshirës, sa më të gjerë dhe sa më të shpejtë të popullatës. Nga java e kaluar Ministria e Shëndetësisë ka filluar vaksinimin me dozën përforcuese dhe dozën e tretë që mund ta marrin të gjithë qytetarët e moshës mbi 18-vjeçare", është thënë në komunikatën e IKShPK-

së.

Instituti ka treguar se kush mund ta marrë dozën përforcuese. "Doza përforcuese u jepet personave të cilët i kanë marrë dy doza të vaksinës kundër Covid-19, por tek të cilët me kalimin e kohës imuniteti i tyre vjen duke rënë. Doza përforcuese jepet 6 muaj pas marrjes së dozës së dytë. Doza e tretë u jepet personave të cilët i kanë marrë dy dozat e vaksinës kundër Covid-19, por tek të cilët nuk është zhvilluar imuniteti i duhur si pasojë e imunitetit të dobët të tyre apo sëmundjeve shoqëruese me rekomandim të mjekut ordinues. Doza e tretë jepet jo më herët se 8 javë dhe pa i bërë 6 muaj nga marrja e dozës së dytë", ka vlerësuar ky institut, duke shtuar se me vaksinim qytetarët mbrojnë veten, njerëzit përreth dhe familjen. Sipas IKShPK-së, vaksinimi mbetet arma më e fortë për ta parandaluar hospitalizimin.

Katër raste të reja me Covid në Kosovë

Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë regjistruar edhe katër raste të reja me Covid-19. Sipas MSh-së, gjatë kësaj periudhe kohore nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes. "Nga 2 368 testime, 4 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes. Sot janë shënuar 7 qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 157 961. Në total numri i

rasteve aktive është 312", është thënë në njoftimin e ministrisë.

Kurse në 24 orët e fundit janë dhënë vetëm 711 vaksinat kundër Covidit. "Në 24 orët e fundit janë dhënë 711 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 654 534 doza të vaksinës. Deri më sot 776 820 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë", ka njoftuar Ministria e Shëndetësisë.



Privilegjet e Serbisë për veriun e Kosovës

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Qeveria e Serbisë me vite të tëra financon projekte në zonat e banuara me shumicë serbe në Kosovë, por të gjitha projektet “e mëdha e të rëndësishme” realizohen në katër komunat veriore të ndërlidhura me territor - Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan. Këtë gjendje dhe “disproporcion të investimeve” e thekson edhe Branimir Stojanović, i cili në zgjedhjet lokale të organizuara nga institucionet e Kosovës në tetor garoi si kandidat i pavarur për kryetar të Graçanicës, njëri prej gjashtë komunave me shumicë serbe në jug të Ibrit. Stojanović thotë se as investimet e Qeverisë së Kosovës në vendbanimet me shumicë serbe nuk ndahen barabartë, por as mjetet financiare nga fondet evropiane. “Shkak mund të jetë ndikimi politik, Lista Serbe, e cila dikur ishte më e balancuar sa i përket ndikimit të përfaqësuesve serbë në jug të Ibrit dhe përfaqësuesve në veri. Tani ekziston dominim absolut i njerëzve që vijnë nga veriu, andaj nuk habitem që këta njerëz punojnë më shumë për

zonat e veta dhe vendet e prejardhjes”, vlerëson Stojanović, i cili ishte një prej themeluesve të Listës Serbe në vitin 2013. Ndërkohë, ai u largua nga partia Lista Serbe dhe një prej arsyeve pse në zgjedhjet e fundit lokale garoi si kandidat i pavarur ishte pikërisht “investimi i pabarabartë në mjediset e banuara me shumicë serbe”. Lista Serbe është një prej partive kryesore të serbëve të Kosovës e cila përkrahet nga Beogradi zyrtar. Kryetari i kësaj partie, Goran Rakić, i cili vjen nga Mitrovica e Veriut, nuk ishte i qasshëm për deklaratë apo koment rreth “investimeve të pabarabarta” në zonat e banuara me shumicë serbe në Kosovë. Ndryshe, Rakić ndodhet edhe në krye të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim në Qeverinë e Kosovës të udhëhequr nga Albin Kurtin. Listës Serbe i takojnë që të dhjetë deputetët në Kuvendin e Kosovës në ulëset e rezervuara për komunitetin serb, por vetëm dy janë nga komunat në jug të Ibrit: Ljubinko Karaxhiq nga Graçanica dhe Branislav Nikoliq nga Shtërpca.

Sa qytetarë serbë ka në jug dhe veri të Ibrit?

Numri i saktë i qytetarëve serbë që jetojnë në Kosovë nuk dihet sepse ata e bojkotuan regjistrimin e popullsisë në vitin 2011 nga Prishtina zyrtare por, sipas disa vlerësimeve të autoriteteve lokale, në komunat veriore jetojnë rreth 70 mijë qytetarë serbë. Po ashtu, bazuar në vlerësimet e autoriteteve lokale, po kaq qytetarë serbë jetojnë në gjashtë komunat e tjera në jug të Ibrit – Graçanicë, Shtërpçë, Novobërdë, Kllokot, Ranillugë dhe Partesh, si dhe në disa zona të të kthyerve në rajonin e Pejës. Komunat në veri të Kosovës, të cilat punojnë brenda sistemit të Kosovës, janë formuar pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Brukselit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në vitin 2013, derisa ato në jug të Ibrit u krijuan pas procesit të decentralizimit në vitin 2009 bazuar në Planin e Marti Ahtisaarit. Kosova, bazuar në këtë dokument, e shpalli pavarësinë në vitin 2008.

Sa investohet në komunat veriore të Kosovës?

Punimet për rinovimin e Qendrës Klinike Spitalore në Mitrovicën e Veriut, e cila punon sipas sistemit të Serbisë, zyrtarisht filluan më 23 nëntor. “Ky do të jetë një objekt bashkëkohor që do t’i përmbushë të gjitha nevojat e qytetarëve dhe kushtet e mjekimit nuk do të dallojnë nga ato në Nish, Kragujevc apo Beograd”, thotë Jelena Stojković, ndihmëse e drejtorit të Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë e cila mori pjesë në nisjen e këtyre punimeve. Institucionet arsimore dhe ato të shëndetësisë në zonat e banuara me popullatë serbe në Kosovë funksionojnë të gjitha sipas sistemit të Serbisë. Kështu, më 20 gusht në Mitrovicën e Veriut u vu edhe guri themeltar për ndërtimin e objektit të “Universitetit të ri të Prishtinës me seli të përkohshme në Mitrovicën e Veriut”, ku mësimi vazhdon të zhvillohet sipas planprogramit

të Serbisë. Ky universitet u zhvendos nga Prishtina pas luftës në Kosovë në vitin 1999. Siç është njoftuar nga Zyra për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, versioni i ri modern i objektit të Universitetit do të shtrihet në rreth 10 575 metra katrorë dhe në të brenda katër katesh do të vendosen: Fakulteti i Shkencave Matematikore, Fakulteti Juridik, Fakulteti Ekonomik dhe Rektorati. Vlera e këtij projekti, siç është njoftuar, do të jetë 6,122,190 euro (720 milionë dinarë serbë), ndërsa paratë nëpërmjet Zyrës për Kosovën i ka ndarë Qeveria e Serbisë. Këtu përfshihen edhe projektet milionëshe si “Lugina e Diellit” dhe “Banja e Parajsës” në Zveçan. Projekti “Lugina e Diellit” është vendbanim i ndërtuar për personat e komunitetit serb të zhvendosur nga Kosova, i cili ka kushtuar rreth 14 milionë euro. Në një sipërfaqe prej rreth 15 hektarësh janë në përfundim e sipër punimet për ndërtimin e rreth 300 njësive banesore. Po ashtu, shumë afër manastirit

Banjska në Zveçan, ku ekzistojnë burimet e ujit termal dhe të sulfurit, është ndërtuar qendra e re turistike e shëndetësore "Banja e Parajsës". Qeveria e Serbisë në këtë projekt ka investuar rreth 2 551 896 milionë euro (300 milionë dinarë serbë).

Sipas të dhënave të Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, nga viti 2014 janë investuar mbi një milion euro për 645 njësi banesore në kuadër të objekteve, të cilat janë ndërtuar në sipërfaqe publike. Vetëm në territorin e komunës së Zubin Potokut janë ndërtuar mbi 60 njësi banesore.

Çfarë ndodhi me investimet në komunat në jug të Ibrit?

Qeveria serbe investon para edhe në vendbanimet serbe në jug të Ibrit, por fjala është për investime kryesisht më të vogla krahasuar me ato në veri.

Sa për shembull, nga mesi i nëntorit, Zyra për Kosovën e Qeverisë serbe njoftoi që ishte vënë gurmtheli për ndërtimin e çerdhes së re në Gorazhdevc afër Pejës. "Ky institucion parashkollor po ndërtohet në tokën e kishës dhe do të shtrihet në një sipërfaqe prej 460

Kujdesi për serbët në Kosovë apo territor?

Dushan Janjiq nga Forumi për marrëdhënie etnike në Beograd vlerëson se "investimet e Qeverisë serbe në Kosovë gjithmonë ishin pjesë e politikës ditore dhe strategjisë", dhe rikujton që në shumicën e rasteve nuk dihet saktë se sa kushton ndonjëri prej projekteve. "Padyshim që për veriun jepet më shumë që nga viti 2009 e nga viti 2016 prejse (presidenti serb, Aleksandar

Vuçiq) luajti me letrën e ndryshimit të kufijve, e ka shtuar shumë financimin për veriun", thotë Janjiq dhe vlerëson që paraardhësi i Vuçiqit, Boris Tadiq, llogariste në "autonomi të posaçme për veriun e Kosovës".

Janjiq konsideron që Beogradi nuk bregoset për serbët që jetojnë në Kosovë, por për territorin e veriut të Kosovës, si pjesë e cila eventualisht do të mund t'i bashkëngjitej

Serbisë. "Nëse shohim jetën politike, Lista Serbe në veri edhe kalon, por në pjesën qendrore gjithmonë ka opozitë. Për politikanët në Beograd ky është ambient i padëshirueshëm. Por, realisht, Beogradi ka heqë dorë nga serbët në pjesën qendrore të Kosovës në aspektin e investimeve shtetërore dhe i trajton sikur pakicë serbe, për shembull, në Slloveni", thekson Janjiq.

metrash katrorë derisa do të pranojë 60 fëmijë. Përfundimi i tij pritet në pranverën e vitit të ardhshëm", është thënë pa dhënë shumë detaje rreth shumës së këtij projekti.

Ndonëse Qeveria e Serbisë qysh në vitin 2018 njoftoi se do të ndajë mjete për ndërtimin e spitalit në Graçanicë, kjo ende nuk është bërë.

Graçanica, pas luftës në Kosovë, u bë qendra kryesore administrative për komunitetin serb që jeton në komunat në jug të Ibrit, marrë parasysh që aty pas luftës u zhvendosën pothuajse të

gjitha institucionet nga Prishtina, por të cilat funksionojnë sipas sistemit të Beogradit.

Po ashtu, pas luftës në Kosovë në vitin 1999, Qendra Klinike Spitalore nga Prishtina u zhvendos në Graçanicë në kontejnerë, madje ende ndodhet aty. Në këtë institucion shëndetësor për shërim udhëzohen qytetarët serbë nga komunat në jug të Ibrit. Edhe vetë mjekët nga Qendra Klinike Spitalore në Graçanicë paralajmëronin në të shkuarën se çfarë gjendje alarmante ekziston në këtë institucion.

A ndikon mungesa e investimeve në mbijetesën e serbëve në jug të Ibrit?

Branimir Stojanović konsideron që mbijetesë e komunitetit serb në zonat e banuara me shumicë serbe në jug të Ibrit do të rrezikohet nëse vazhdon "disproporcioni i investimeve të përgjithshme". "Jeta dhe ky raport është pjesa më traumatike. Serbët këtu mbijetuan me më shumë apo më pak para, por me më shumë

apo më pak respekt dhe mundësi që të ndikojnë në gjërat rreth vetes ka qenë vendimtare për njerëzit se a do të mbeteshin këtu apo jo. Në situatën aktuale, ku ata shumë pak ose aspak nuk kanë ndikim në procese dhe vendime si dhe në jetën e tyre, njerëzit po largohen nga këtu", thotë Stojanović.

Ai thekson se "po krijohet atmosferë që më të dëgjueshmit po favorizohen e jo ata të cilët mund ta avancojnë jetën e qytetarëve serbë në Kosovë".

Megjithatë, sipas tij, serbët që jetojnë në jug të Ibrit gjithnjë e më shumë po i potencojnë pakënaqësitë e tyre në zgjedhje, pavarësisht se Lista Serbe edhe në zgjedhjet e fundit lokale fitoi në dhjetë komuna të banuara me shumicë serbe në Kosovë. "Kjo fitore është gjithnjë e më pak bindëse", thotë Stojanović duke shprehur bindjen që populli po bëhet më i guximshëm kur është fjala për të votuar dhe se voton nga bindja e jo bazuar në premtime apo presion.

Në zgjedhjet e fundit lokale të organizuara nga institucionet e Kosovës, Branimir Stojanović fitoi mbi 1 800 vota apo rreth 22 për qind. (Rel)



Institucionet heshtin për investime në pjesët e banuara me serbë

Radio Evropa e Lirë i është drejtuar Ministrisë së Financave të Qeverisë së Kosovës me pyetjen se sa para këtë vit janë ndarë për realizimin e projekteve kapitale në vendet me shumicë serbe në jug të Ibrit,

por përgjigje nuk pati. Përgjigje nuk kanë dhënë as nga Zyra për Kosovën në Qeverinë e Serbisë në pyetjen se sa para investohen në zonat e banuara me shumicë serbe në Kosovë dhe përse pothuajse të gjitha projektet

realizohen në komunat veriore të Kosovës. Përndryshe për katër komunat në veri të Kosovës ekziston edhe Fondi Zhvillimor i themeluar në vitin 2013 në bazë të Marrëveshjes së Brukselit nga

viti 2013. Në këtë fond derdhen paratë nga tatimet e grumbulluara në pikat kufitare 1 dhe 31 (Jarinjë e Bërnjak në veri të Kosovës) dhe janë të dedikuara për zhvillimin në katër komunat në veri të Kosovës: Mitrovicë e Veriut,

Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan. Nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë nuk i janë përgjigjur pyetjes se sa është vlera e këtij fondi deri më tash dhe sa para janë shpenzuar për projekte në komunat në veri të Kosovës. (Rel)

Ministri Mehaj thotë se qeveria po tregon përkushtim për zhvillimin e FSK-së



PRISHTINË, 19 DHJETOR - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka thënë se miratimi i projektbuxhetit për vitin 2022 me mbi 100 milionë euro për Ministrinë e Mbrojtjes kap vlerën prej 1.3 % të Bruto Produktit

Vendor, me synim që gjatë mandatit të arrijnë në 2 %, sipas standardit të përcaktuar të NATO-s. “Kjo dëshmon përkushtimin tonë serioz qeveritar për zhvillimin dhe avancimin e aftësive dhe kapaciteteve

operacionale të FSK-së për t’i realizuar suksesshëm detyrat tona kushtetuese dhe ligjore. Ne kemi pak fjalë e shumë punë! Urime e na priftë e mbara!”, ka shkruar Mehaj në llogarinë e vet në “Facebook”.

Tahiri: Protesta sot në Tiranë është edhe në mbrojtje të Kosovës, të përkrahjet nga të gjithë shqiptarët

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Ish-kryenegociatorja e Kosovës për bisedime me Serbinë, Edita Tahiri, ka bërë me dije se “Ballkani i hapur” do t’i vendosë popujt në hegjemoninë serbe. “Kështu ëndërron Vuçiqi në prag të arritjes në Tiranë nesër, më 20

dhjetor”, ka shkruar Tahiri në llogarinë e vet në “Facebook”. Ajo thotë se opozita e ringjallur e Shqipërisë nesër do t’i tregojë se ai vetëm mund të ëndërron. “Protestat nesër në Tiranë janë edhe në mbrojtje të Kosovës dhe duhet të përkrahjet nga të gjithë shqiptarët!”, ka shkruar

Tahiri. Ish-kryeministri Sali Berisha ka bërë thirrje për protestë të hënën kundër, siç ka thënë ai, “paktit antikombëtar Rama - Vuçiq”. Ai i ka ftuar qytetarët që në orën 16:00 para selisë së PD-së të mblidhen dhe pastaj të shkojnë drejt ndërtesës së qeverisë.



Kurti thotë se LV-ja do të jetë opozitë kryesore nëpër komunat që nuk i qeveris

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Kryeministri i Kosovës, njëherësh kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë se partia e tij do të jetë e përkushtuar në komunat ku qeveris, ndërsa do të jetë opozitë kryesore nëpër komunat e tjera të Kosovës. Këto komente Kurti i bëri në mbledhjen me qendrat e Lëvizjes Vetëvendosje, ku morën pjesë, përveç Kurtit, edhe kryetarja organizative Vlorë Haxhimemedi dhe koordinatori i qendrave, Valon Hoti.

Sa i përket situatës politike, kryeministri Kurti njoftoi edhe një herë përfaqësuesit e



qendrave të Lëvizjes për madh deri tani në vlerë prej 2 miratimin e buxhetit për vitin miliardë e 748 milionë eurosh. 2022 që është edhe buxheti më i

mirëqenies, solidaritetit dhe investimeve. Aty gjenden fondet e ndara për mbështetje të prodhuesve vendorë dhe bujqve, fondet për ringjallje të ndërmarrjeve publike, shtesat për nënat lehona e fëmijët, shtesat për familjet me asistencë sociale dhe pensionistët, e deri tek investimet në fushat si ajo e shëndetësisë, sigurisë, infrastrukturës, kulturës e rinisë. Në anën tjetër, Lëvizja Vetëvendosje do të jetë e përkushtuar edhe në komunat ku qeveris, dhe do të jetë opozitë kryesore nëpër komunat e tjera të Kosovës”, citohet të ketë thënë Kurti.

Në mbledhjen e përbashkët me qendrat u fol edhe për zgjedhjet e brendshme të cilat u tha se do të rinisin në fillimvitin që po vjen, të cilat ishin ndërprerë për shkak të pandemisë dhe zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare. Të gjitha qendrat ishin njëzëri dakord për ta filluar procesin e brendshëm zgjedhor prej nga u tha se “do të dalim edhe më të fuqishëm edhe më të organizuar”. “Mbështetjes dhe rritjes së madhe të LV-së duhet t’ia mbështesim një organizatë edhe më të fortë”, është thënë në këtë mbledhje, sipas njoftimit të LV-së.

Testohen 180 kandidatë për prokurorë të shtetit në Kosovë

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike në Vushtrri po mbahet testi me shkrim i kandidatëve të cilët kanë kaluar testin kualifikues për prokurorë të shtetit. Kështu është bërë me dije përmes një komunikate për medie, teksa në kuadër të këtij procesi rekrutues të 16 prokurorëve në prokuroritë themelore morën pjesë 180 kandidatë, prej të cilëve 62 kandidatë i përkasin gjinisë femërore, kurse një është nga radhët e komuniteteve joshumicë. “Mbajtjen e testit të sotëm me shkrim e mbikëqyren

anëtarët e Komisionit për Rekrutim të Këshillit Prokurorial të Kosovës, kurse për ta monitoruar këtë proces ishin të pranishëm përfaqësues të Misionit për Sundimin e Ligjit në Kosovë - EULEX, Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë - OSBE dhe Grupit për Studime Juridike dhe Politike - GLPS, ndërsa për të vëzhguar ishin të pranishëm përfaqësues të Programit të Bashkimit Evropian për Sektorin e Drejtësisë në Kosovë - EUKOJUST dhe përfaqësues të Projektit të Ambasadës Britanike në Kosovë

“Forcimi i sistemit të drejtësisë në Kosovë” përmes partnerëve implementues “Axiom International”, thuhet në komunikatën për media. Procesi i rekrutimit të prokurorëve ka filluar me shpalljen e konkursit në qershor të vitit 2020 dhe me rishpalljen e tij në maj të vitit 2021. Testi me shkrim për rekrutimin e prokurorëve të rinj të shtetit është pjesë e fazës së dytë të testimit të përgjithshëm, të cilin Këshilli Prokurorial i Kosovës e menaxhon sipas standardeve më të avancuara ndërkombëtare.



Sa dini për tarifën shtesë të Trustit?

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Mbi 2.3 miliardë euro ka arritur vlera e kursimeve të mbi 700 mijë kontributpaguesve që i menaxhon Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës (FKPK) apo, siç njihet ndryshe, Trusti.

Për menaxhimin e këtyre mjeteve qytetarët paguajnë dy tarifa ose rreth 40 euro në vit, varësisht nga bilanci në llogaritë e tyre.

Sikurse çdo vit, këto tarifa janë miratuar më 13 dhjetor nga Kuvendi i Kosovës, pas kërkesës së FKPK-së.

Njëra tarifë quhet operacionale, ndërsa tjetra investive.

Për tarifën investive qytetarët paguajnë 0.32 për qind, kurse për atë operacionale 0.057 për qind, varësisht nga bilanci kontribuues që kanë në llogari.

Nga këto dy tarifa Fondi i Kursimeve Pensionale të

Kosovës vitin e kaluar ka arritur të grumbullojë rreth tetë milionë euro.

Rreth 1.2 milion euro nga kjo shumë ndalen për t'i mbuluar shpenzimet dhe nevojat e punëtorëve të Trustit.

Jeton Demi, zëdhënës në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës, tregon se tarifa operacionale shpenzohet për nevojat e funksionimit të institucionit, duke filluar nga qiraja e zyrës, pagat e deri te postimi i pasqyrave të llogarisë dhe shpenzimet e tjera për operim.

FKPK-ja është institucion që nuk financohet nga buxheti i Kosovës, por financohet duke ngarkuar tarifa menaxhuese mbi mjetet nën administrim, përkatësisht mjetet pensionale.

Tarifa për investime, ndërkaq, shkon për menaxhuesit e

mjeteve për investime, pasi pjesa më e madhe e fondit menaxhohet në tregjet ndërkombëtare.

Me gjithë miratimin e përvitshëm të tarifave nga Kuvendi i Kosovës, disa qytetarë të anketuar nga "Radio Evropa e Lirë" nuk janë në dijeni se Trusti ndal para për menaxhimin e investimeve.

Albert Gashi, punonjës në sektorin privat, thotë se nuk ka informacione për pagesa të tilla. "Hiç nuk e di, nuk e di. Pse, edhe Trusti ndal para?", thotë Gashi.

Trusti u ofron kontribuuesve qasje online në llogaritë e tyre të kursimeve pensionale.

Naimi, punonjës në njërin nga institucionet publike, thotë se ka qasje në llogarinë e kursimeve por, siç shton, ai nuk u ka kushtuar vëmendje taksave që i ndalen. "Realisht e shikoj bilancin e llogarisë çdo muaj.

Taksat nuk i kam parë. Nuk e kam të qartë pse paguhen këto taksa dhe nuk e di as shumën mujore apo vjetore që paguaj për menaxhimin e mjeteve", thotë ai. Blerina Haziraj thotë se ka informacione për disa tarifa, por jo edhe për shumën. "Trusti e dërgon pasqyrën e llogarisë vjetore, por nuk e di sa paguaj", thotë ajo.

Jeton Demi, zëdhënës në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës, sqaron se sa paguajnë qytetarët për këto llogari: "Te tarifa investuese 0.32 për qind, kjo varet nga bilanci që personi ka në llogari. Por, marrim një llogari prej rreth 10 mijë eurosh, tarifa vjetore është rreth 32 euro ose 2.6 euro në muaj". "Në rastin e tarifës operacionale, prapë po e marrim një llogari prej 10 mijë eurosh, kontributpaguesi duhet të paguajë 5.7 euro në vit ose 50

centë në muaj. Por, nëse vlera është më e vogël, kjo vlerë shkon deri në 20 centë në muaj, pasi rreth 80 për qind e llogarive janë nën 10 mijë euro", thotë Demi.

Arsyeja e këtyre tarifave, shton ai, ndërlidhet me funksionimin e institucionit, por edhe me ruajtjen e vlerave të investimeve pensionale. Sipas tij, FKPK ngarkon tarifa të ulëta menaxhuese dhe është ndër fondet pensionale me tarifa më të ulëta në Ballkanin Perëndimor.

Të gjithë të punësuarit në Kosovë paguajnë 10 për qind kontribute pensionale nga paga e tyre: 5 për qind i paguan punëdhënësi, kurse 5 për qind ndahen nga paga e të punësuarit. Kursimet pensionale mund të përdoren nga kontribuuesi vetëm pasi t'i përmbushë kriteret për pension, përkatësisht moshën 65 vjeç.



Kuvendi miraton në lexim të dytë buxhetin për vitin 2022

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë miratuar në shqyrtim të dytë Projektligjin mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e vitit 2022.

Me 65 vota për Kuvendi i Kosovës ka miratuar buxhetin prej 2.7 miliardë eurosh.

Asnjë nga deputetët nuk ka votuar kundër, derisa kishte vetëm një abstenim.

Miratimi i buxhetit, që iu shtuan mbi 80 amendamente, u bë në një seancë të jashtëzakonshme, e cila u kundërshtua nga opozita. Me këtë rast, kryeministri Albin Kurti ka falënderuar deputetët që votuan buxhetin për vitin 2022. Ai ka shkruar në "Facebook" se ky do të jetë buxhet i zhvillimit pasi, sipas tij, me 40 milionë euro do të mbështesin prodhuesit vendorë, me 40 milionë euro të tjera do ta

mbështetin ringritjen e ndërmarrjeve publike si "Trepça" dhe "Telekomi, 70 milionë euro për bujqësinë. "Kurse për punësimin e garantuar për të rinjtë kemi ndarë edhe 20 milionë euro. Krijimi i vendeve të reja të punës është prioritet i koduar edhe në këtë buxhet. Ky do të jetë buxhet i mirëqenies dhe solidaritetit sepse kemi ndarë 45 milionë euro për shtesat për lehona dhe fëmijë, sepse kemi ndarë edhe 35 milionë euro për t'u siguruar se asnjë pension nuk mbetet nën 100 euro, dhe secilës familje në asistencë sociale shtesa prej 30 % i bëhet e përhershme. Ky është buxhet i investimeve sepse me mbi 700 milionë euro do të investojmë në arsim e shëndetësi, kulturë e sport, infrastrukturë e siguri. Na priftë e mbara!", ka shkruar Kurti.



AFRIM MYRTAJ HEROI I GJALLË I KOMBIT I GODITUR ME MBI 11 PLUMBA NË TRUP



AFRIM MYRTAJ



Ismet SYLEJMANI

Shtati i shqiptarit Afrim Myrtaj nga Gjlani, është në mesin e atyre të paktëve pjestarë të popullit shqiptar që është goditur nga plumbat e armikut mbi 11 herë dhe ka qendruar stoik e i ka përballuar me sukses të gjitha vështirësitë që dalin nga rafalet e predhëve të mitralozit të armikut! Ushitari luftëtar çlirimtar i popullit shqiptar Afrim Myrtaj, është njëri prej pjestarëve lavdimadh të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës!

Afrim Myrtaj është dhe do të mbetet emer i madh në luftën e armatosur të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në përgjithësi dhe i Zonës Operative të Karadakut në

veçanti!

Populli shqiptar e ka per nderë qe e ka djalë të Tij këtë titan, i cili sikur Gjergj Elez Alia e sikur Jakup Ferri, por edhe sikur shumë emra të mëdhenj e të pavdekshëm të arenave të luftërave heroike të bijëve të lavdishëm të kombit tonë, do të jetë i shënuar me shkronja ari në historinë legjendare të luftëtarëve të mëdhenj e viganë të betejave kundër pushtuesve e armiqëve të ndryshëm të Atdheut tonë, sepse edhe me aq plagë në trup ka ecur e ka marshuar në kolonë ushtarake në këmbët e veta!

Për të gjithë njerzit e planetit ditëlindjet kanë kuptim, sepse ato simbolizojnë hallkat e renditura të viteve njëri pas tjetrit, por te Afrim Myrtaj, te ky emër i madh i kalendarit të të gjallëve, të cilët jetën e kanë fitore në fushbetej, ndryshojnë gjerat, marrin kuptim tjetër dhe përbëjnë eveniment qe i tejkalon kufijtë e normalës njerëzore dhe ngjiten lartë e gozhdohen përgjithmonë në renditjen mbinormale e mbinjerëzore të thesarit të

paqmuar kombëtar!

Gjak e plagë i ka dhënë Afrim Myrtaj luftës për liri e çlirim të Kosovës nga Serbia pushuese!

Të gjithë i madh e i vogël duhet ta dijmë, se sa dhe ku i ka nëpër trup plagët e lirisë hero i gjallë i kombit Afrim Myrtaj!

Sa plagë ka përpara, sa mbrapa dhe sa anash në shtatin e Tij, i pamposhturi Afrim Myrtaj!

Me çfarë plumbash është goditur nga armiqt pushtues çlirimtar Afrim Myrtaj në shtatin e tij muskuloz!

Çfarë kalibrash ishin plumbat që e kanë goditur në shtatin e Tij, atë ditë në ofenziven shfarosëse të forcave serbe në Malësinë e Zhegocit të Gjilanit!

Gjlani dhe jo vetëm, e ka për obligim detyruar që ta nderojë për të gjallë këtë luftëtarë, ndonëse është bërë vonë, sepse kanë kaluar shume vite pas perfundimit të luftës e pas çlirimit të Kosovës nga okupimi serb, por fjala e popullit thotë kurrë vonë nuk është, më mirë vonë se kurrë!

Popujt e qytetëruar e me

demokraci të lashtë, por edhe me demokraci moderne, pjestarët e tyre të shtrenjtë e me kontribute të mëdha, të cilët vepra e tyre i bënë edhe të shenjtë, jo vetëm i kanë të rrallë dhe i mbajnë në pëllëmbë të dorës e në majat më të larta të nderimit popullorë e qytetarë, por edhe i skalisin në skulptura e monumente dhe i shkrijnë edhe në bronz!

Afrim Myrtaj duhet të ketë të njëjtën masë të trajtimit nderues e respektues nga populli, nga Atdheu e nga Kombi ynë!

Ti me 15 Dhjetor 2021, ke mbushur 47 vjetë!

Të gjithë e dijmë se Ti ke lindur për së dyti, të ka ruajtur zoti, sepse për Serbinë je i vranë, je i vdekur!

Nëna Jote e madhe dhe Beteja heroike e Epopesë së Zhegocit, janë vendlindjet Tua të mëdha e historike!

Te ti jetëgjatësia ka kuptim të madh, sepse Ti e ke mundur vdekjen dhe e ke shpërndarë me gjakë sihariqin e madh të fitores, në ditën kur bashkë me Ty, e në rresht të parë ranë në frontin e

luftës për liri Heronjtë e Kombit Pajazit Ahmeti e Alban Ajeti, dhe aty u vranë në prite edhe qifti bashkëshortorë heroik i UÇK-së Tefik dhe Hanumshahe Zymeri por bashk me ta edhe pjestarë të tjerë të popullit shqiptar të rrethuar nga forca të mëdha ushtarake policore serbe!

Gjeneratat e popullit shqiptarë do të nderojnë e do të përkulen për Ty e në nderim të luftës Tënde, të gjakut Tënd të derdhur për liri dhe të plagëve të shumta që ke marrë në luftën e armatosur frontale me ushtrinë dhe policinë e Serbisë pushtuese!

Populli shqiptar në përgjithësi, Zona Operative e Karadakut të UÇK-së dhe Gjlani ne veçanti, e ka për obligim kombëtar e luftarak çlirimtar, me ta festu çdo ditëlindje Tëndën!

Urimet më të mira për ditëlindjen, bashkëlufëtari ynë Afrim Myrtaj!

Jetë të gjatë e të lumtur triumfatori i UÇK-së e i popullit shqiptar!

Gëzuar!

Gjilan, 17 Dhjetor 2021!

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Enverti
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Driton Kuka dhe Distria Krasniqi, më të mirët në botë për xhudo

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Trajneri i kombëtares së Kosovës në xhudo, Driton Kuka, është zgjedhur trajneri më i mirë në botë për vitin 2021 nga Federata Ndërkombëtare e Xhudos (IJF). Driton Kuka ka qenë fantastik në këtë vit, duke i udhëhequr Distria Krasniqin dhe Nora Gjakovën në Lojërat Olimpikë

“Tokio 2020”, të cilat fituan medalje të arta. Kjo është hera e parë që një trajner nga Kosova zgjedhet trajneri më i mirë në botë për xhudo. Edhe kampionja olimpikë, Distria Krasniqi, është zgjedhur xhudistja më e mirë në botë për vitin 2021 nga Federata Ndërkombëtare e Xhudos.



Kosova U19 barazon në miqësoren e dytë me Maqedoninë e Veriut U20



SHKUP, 19 DHJETOR - Kombëtarja e Kosovës U19 ka barazuar 3:3 në miqësoren e dytë kundër Maqedonisë së Veriut U20 që është zhvilluar në qendrën stërvitore të FFMV-së në Shkup. Për dallim nga ndeshja e parë, kjo e sotmja ishte shumë më interesante dhe prodhoi shumë raste e gola. Ndonëse futbollistët e Maqedonisë së Veriut ishin gjeneratë më e madhe, kjo në

lojë e sotme nuk u vërejt aspak, ngaqë djelmoshat e Ramiz Krasniqit treguan lojë shumë të mirë, madje ishin shumë afër fitores. Të parët në epërsi kaluan vendasit me golin e Trpcevskit. Megjithatë, pjesën e dytë Dardanët e rinj e nisën në mënyrë të shkëlqyeshme duke përmbytur rezultatin me tre gola radhazi në periudhën nga minuta e 57-të deri në të 72-tën.

Fillimisht shifrat i barazoi Orges Sjarina, më pas Andi Kadriu shënoi për 2:1, derisa Orges Sjarina çoi shifrat në 3:1 me golin e tij të dytë. Mirëpo, Maqedonia e Veriut iu shmang humbjes me golat e shënuar nga Krstevski nga penalltia (74') dhe Todorovskit (78'). Të rikujtojmë se ndeshja e parë mes këtyre dy ekipeve përfundoi me fitoren minimale të vendasve 1:0.

Të hënën nis afati kalimtar në basketboll

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Afati kalimtar në basketboll do të fillojë më 20 dhjetor dhe do të mbarojë më 30 dhjetor ka bërë me dije Federata e Basketbollit e Kosovës. “Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) ju njofton se afati kalimtar për lojtarë/e vendorë dhe të huaj/a fillon më 20 dhjetor (e hënë), ndërsa do të përfundojë më 30 dhjetor në orën 16:00. Të gjitha



transferimet e lojtarëve/eve duhet të paraqiten në postën elektronike, duke respektuar procedurat e afatit kalimtar. Klubet kanë mundësi t'i bëjnë transferimet brenda afatit kalimtar, që nuk pritet të jenë të pakta, varësisht nga synimet që kanë, ndërsa në stinorin pranveror pritet një garë shumë interesante dhe rivalizuese”, ka njoftuar FBK-ja.

Presidenti FFK-së takon Samuel Eto'on

PRISHTINË 19 DHJETOR - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, ndodhet për vizitë në Doha për të përcjellë nga afër ndeshjen finale të turneut FIFA Arab Cup 2021 ndërmjet Algjerisë dhe Tunizisë. Ai po qëndron në kryeqytetin e Katarit me ftesë të presidentit të FIFA-s, Gianni Infantino dhe të presidentit të Federatës së Futbollit të Katarit, Hamad Bin Khalifa Bin Ahmed Al-Thani. Në prag



të kësaj ndeshjeje, presidenti Ademi ka takuar legendën e futbollit, Samuel Eto'o. Ai me këtë rast e ka përgëzuar ish-yllin e Barcelonës dhe disa klubeve të tjera evropiane për zgjedhjen e tij president i Federatës së Futbollit të Kamerunit, duke i uruar rugëtim të suksesshëm në krye të këtij institucioni. Po ashtu, ata u pajtuan që në të ardhmen dy federatat të kenë bashkëpunime.

Manchester City thyen rekordin e Liverpoolit të vendosur në vitin 1982

MANCHESTER, 19 DHJETOR - Manchester City me Pep Guardiolen ka vendosur një rekord historik në Ligën Premierë. Citizens fitoi 4-0 në udhëtim te Newcastle

Unitedi, duke bërë që të vendosin rekord të ri në ligë. Manchester City është bërë skuadra e parë në histori të Ligës Premierë që merr më së shumti fitore, duke thyer

kështu rekordin e Liverpoolit. Ky rekord ishte vendosur nga The Reds në vitin 1982. Po ashtu, kampioni në fuqi i Ligës Premierë ka thyer edhe

rekordin e vet, pasi ka shënuar më së shumti gola brenda një viti kalendarik. Për vitin 2021 City ka marrë 34 fitore, derisa ka shënuar 106 gola.



Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Edis Gashi shpall te pavlefshme dëftesën e kl XI dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

▶ Shake Hadergjonaj shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

▶ Eren Halabak shpall te pavlefshme dëftesën e kl VI - IX shfmu " Avdyl Frasheri " Prizren.

▶ Gresa Selmani shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Bajram Curi" Krush e Madhe.

▶ Ndriqim Kryeziu shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Abdyl Frasheri " Prizren.

▶ Egzon Rashkaj shpall te pavlefshme diplomën shmlt " Ymer Prizreni " Prizren.

▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

▶ Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

